



INDEKSI I KËNAQSHMËRISË SË QYTETARËVE ME SHËRBIMET KOMUNALE NË PRISHTINË

INDEKSI I KËNAQSHMËRISË SË QYTETARËVE ME SHËRBIMET KOMUNALE NË PRISHTINË

Prishtinë, qershor 2018

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Organizatës Iniciativa për Progres – INPO dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Shënim:

Në mbledhjen e përqindjeve të përgjigjeve të të anketuarve në disa raste mbledhja nuk del të jetë 100.00% por ekziston gabimi +/- 0.02%. Kjo për shkak të rrumbullaksimit automatik të përqindjes në numër decimal me dy numra pas presjes dhjetore që është bërë nga softuer i përdorur për analizimin e të dhënave sasiore.

Qershor 2018

Ky botim nuk ka të drejta autoriale. Të gjitha të dhënat dhe përmbajtja e këtij botimi mund të përdoren plotësisht ose pjesërisht pa të drejtën autoriale të Organizatës Iniciativa për Progres – INPO. Sidoqoftë, duhet të citohet burimi.

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë të pjesëmarrësve të anketës dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e INPO-së.

Përmbajtja

Rreth INPO-së.....	7
Lista e figurave në dokument.....	8
Lista e tabelave në dokument	10
Hyrje	13
Përmbledhje ekzekutive	14
Metodologjia e hulumtimit.....	21
Demografia e të anketuarve.....	22
Shërbimet administrative.....	25
Shëndetësia	27
Arsimi	29
Sporti	31
Kulturë dhe rini.....	33
Infrastruktura rrugore dhe mirëmbajtja	35
Trotuaret.....	37
Ndriçimi publik	38
Parkingjet publike	39
Parqet, sheshet dhe hapësirat publike.....	40
Transporti publik.....	42
Uji i pijshëm	44
Mbeturinat	46
Kanalizimi	47
Planifikimi urban dhe rural.....	48
Kënaqshmëria me pushtetin lokal.....	49
Transparenca	52
Vendimmarrja.....	54
Shtojcë: Rezultatet e detajuara të anketës	56

Rreth INPO-së

Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar në vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës avokohet për çështje shoqërore, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Vizioni i Organizatës INPO është për institucione lokale që qeverisen me vlera demokratike ku qytetari është bashkëvendimmarrës, ndërsa INPO për mision ka promovimin e demokratizimit të qeverisjes lokale përmes aktivizimit qytetar dhe përkushtohet në avansimin e vlerave të një shoqërie të hapur.

Vizioni dhe misioni i Organizatës INPO përmbushen përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të Organizatës: (i) Programi për Qeverisje të Mirë, dhe (ii) Programi për Zhvillim Demokratik. Ky dokument është produkt i Programit për Qeverisje të Mirë, program i cili ka për qëllim promovimin e qeverisjes së përgjegjshme duke nxitur përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, transparencë, llogaridhënie dhe sundim të ligjit.

INPO që nga themelimi ka shtyrë përpara agjendat për më shumë transparencë në shpenzimet financiare publike, përfshirjen më të mirë dhe më të gjerë të qytetarëve në proceset e vendimmarrjes publike dhe rritjen e llogaridhënies së zyrtarëve publik të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe sjelljeve të tjera të këqija në institucionet publike.

Lista e figurave në dokument

Figura 1: Kënaqshmëria e përgjithshme me shërbimet publike komunale, pjesa e parë	18
Figura 2: Kënaqshmëria e përgjithshme me shërbimet publike komunale, pjesa e dytë	19
Figura 3: Kënaqshmëria e përgjithshme me shërbimet publike komunale, pjesa e tretë	20
Figura 4: Demografia e të anketuarve – Mosha e të anketuarve.....	22
Figura 5: Demografia e të anketuarve – Gjinia e të anketuarve.....	23
Figura 6: Demografia e të anketuarve – Vendbanimi i të anketuarve	23
Figura 7: Demografia e të anketuarve – Niveli i arsimimit i të anketuarve	24
Figura 8: Demografia e të anketuarve – Statusi i punës i të anketuarve.....	24
Figura 9: Shërbimet administrative – Vizitimi i komunës nga qytetarët në 12 muajt e fundit për të kryer shërbime administrative; Efikasiteti i komunës/administratës publike në lëshimin e dokumenteve.....	25
Figura 10: Shërbimet administrative - Kënaqshmëria e qytetarëve me saktësinë dhe shpejtësinë në marrjen e dokumentit/shërbimit të kërkuar herën e fundit kur e kanë vizituar komunën	26
Figura 11: Shëndetësia – Kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet shëndetësore të ofruara nga QKMF-ja, QM-të dhe ambulancat shëndetësore.....	27
Figura 12: Shëndetësia – Arsyet e pakënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet shëndetësore të ofruara nga QKMF-ja, QM-të dhe ambulancat shëndetësore.....	28
Figura 13: Arsimi – Kënaqshmëria e qytetarëve me cilësinë e arsimit parauniversitar .	29
Figura 14: Arsimi – Kënaqshmëria e qytetarëve me infrastrukturën e ambienteve shkollore	30
Figura 15: Sporti – Kënaqshmëria e qytetarëve me organizimin e aktiviteteve sportive	31
Figura 16: Sporti – Kënaqshmëria e qytetarëve me mbështetjen komunale të klubeve sportive	32
Figura 17: Kulturë dhe rini – Kënaqshmëria e qytetarëve me organizimin e aktiviteteve kulturore sikurse shfaqjet teatrale, festivalet, orët letrare, panairët e ndryshme	33
Figura 18: Kulturë dhe rini – Kënaqshmëria e qytetarëve me organizimin e aktiviteteve rinore	34
Figura 19: Infrastruktura rrugore dhe mirëmbajtja - Kënaqshmëria e qytetarëve me gjendjen e rrugëve, përfshirë cilësinë e asfaltimit dhe gjerësinë e rrugëve; Kënaqshmëria	

e qytetarëve me mirëmbajtjen e rrugëve (intervenimet nga komuna kur demolohehen rrugët, hapen gropat, prishet struktura e asfaltit); Kënaqshmëria e qytetarëve me sinjalistikën rrugore, shenjat për këmbësorë, shpejtësinë e kufizuar, paralajmërimin për afërsinë e shkollave, hapësirave publike	36
Figura 20: Trotuaret – Kënaqshmëria e qytetarëve me trotuaret (gjatësinë e tyre, gjerësinë, mundësitë për lëvizje dhe mirëmbajtjen e tyre).....	37
Figura 21: Ndriçimi publik – Kënaqshmëria e qytetarëve me ndriçimin publik në rrugë dhe hapësira publike (parqe, sheshe)	38
Figura 22: Parkingjet publike – Kënaqshmëria e qytetarëve me ekzistencën e hapësirave publike për parkingje	39
Figura 23: Parqet, sheshet dhe hapësirat publike – Kënaqshmëria e qytetarëve me numrin e parqeve dhe shesheve; Kënaqshmëria e qytetarëve me mundësitë që ofrojnë sheshet për rekreacion, tubime, shëtitje etj.; Kënaqshmëria e qytetarëve me hapësirat gjelbëruese në vende publike; Kënaqshmëria e qytetarëve me mirëmbajtjen e parqeve, shesheve dhe hapësirave publike	41
Figura 24: Transporti publik – Kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet e transportit publik	43
Figura 25: Transporti publik – Kënaqshmëria e qytetarëve me oraret e qarkullimit të transportit publik	43
Figura 26: Uji i pijshëm – Kënaqshmëria e qytetarëve me përfshirjen në sistemin e ujësjellësit; Kënaqshmëria e qytetarëve me furnizimin me ujë; Kënaqshmëria e qytetarëve me cilësinë e ujit.....	45
Figura 27: Mbeturinat – Kënaqshmëria e qytetarëve me grumbullimin e mbeturinave, përfshirë respektimin e orarit të grumbullimit të tyre	46
Figura 28: Kanalizimi – Kënaqshmëria e qytetarëve me trajtimin e ujërave të zeza/kanalizimit	47
Figura 29: Planifikimi urban dhe rural – Kënaqshmëria e qytetarëve me planifikimin urban dhe rural.....	48
Figura 30: Kënaqshmëria me pushtetin lokal – Kënaqshmëria e qytetarëve me punën e kryetarit të komunës; Kënaqshmëria e qytetarëve me punën e kuvendit komunal; Kënaqshmëria e qytetarëve me punën e drejtorive komunale	50
Figura 31: Kënaqshmëria me pushtetin lokal – Ndryshimet në nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve për punën e kryetarit të komunës, kuvendit komunal dhe drejtorive komunale	51
Figura 32: Transparenca – Informimi i qytetarëve me punën e komunës	52

Figura 33: Transparenca – Informimi i qytetarëve në 12 muajt e fundit për ndonjë takim publik, mbledhje të kuvendit apo takim tjetër të organizuar nga komuna.....	53
Figura 34: Vendimmarrja – Pjesëmarrja e qytetarëve në 12 muajt e fundit në ndonjë takim publik për shqyrtimin e një dokumenti strategjik, apo rregullore komunale; Pjesëmarrja e qytetarëve në ndonjë takim për planifikimin e buxhetit komunal	54
Figura 35: Vendimmarrja – Në rast të pjesëmarrjes qytetarëve në takime publike për planifikimin e buxhetit komunal, marrja parasysh e kërkesave të tyre	55

Lista e tabelave në dokument

Tabela 1: Demografia e të anketuarve – Të dhënat e detajuara në bazë të moshës së të anketuarve	57
Tabela 2: Demografia e të anketuarve – Të dhënat e detajuara në bazë të gjinisë së të anketuarve	58
Tabela 3: Demografia e të anketuarve – Të dhënat e detajuara në bazë të vendbanimit të të anketuarve.....	59
Tabela 4: Demografia e të anketuarve – Të dhënat e detajuara në bazë të nivelit të arsimimit të të anketuarve	60
Tabela 5: Demografia e të anketuarve – Të dhënat e detajuara në bazë të nivelit të statusit të punës së tyre	61
Tabela 6: Shërbimet administrative – Vizitimi i komunës nga qytetarët në 12 muajt e fundit për të kryer shërbime administrative.....	62
Tabela 7: Shërbimet administrative – Efikasiteti i komunës/administratës publike në lëshimin e dokumenteve	63
Tabela 8: Shërbimet administrative – Kënaqshmëria e qytetarëve me saktësinë dhe shpejtësinë në marrjen e dokumentit/shërbimit të kërkuar herën e fundit kur e kanë vizituar komunën	64
Tabela 9: Shëndetësia – Kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet shëndetësore të ofruara nga QKMF-ja, QM-të dhe ambulatat shëndetësore.....	65
Tabela 10: Shëndetësia – Arsytet e pakënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet shëndetësore të ofruara nga QKMF-ja, QM-të dhe ambulatat shëndetësore.....	66
Tabela 11: Arsimi – Kënaqshmëria e qytetarëve me cilësinë e arsimit parauniversitar .	67
Tabela 12: Arsimi – Kënaqshmëria e qytetarëve me infrastrukturën e ambienteve shkollore	68

Tabela 13: Sporti – Kënaqshmëria e qytetarëve me organizimin e aktiviteteve sportive	69
Tabela 14: Sporti – Kënaqshmëria e qytetarëve me mbështetjen komunale të klubeve sportive	70
Tabela 15: Kulturë dhe rini – Kënaqshmëria e qytetarëve me organizimin e aktiviteteve kulturore sikurse shfaqjet teatrale, festivalet, orët letrara, panairët e ndryshme	71
Tabela 16: Kulturë dhe rini – Kënaqshmëria e qytetarëve me organizimin e aktiviteteve rinore	72
Tabela 17: Infrastruktura rrugore dhe mirëmbajtja – Kënaqshmëria e qytetarëve me gjendjen e rrugëve, përfshirë cilësinë e asfaltimit dhe gjerësinë e rrugëve	73
Tabela 18: Infrastruktura rrugore dhe mirëmbajtja – Kënaqshmëria e qytetarëve me mirëmbajtjen e rrugëve (intervenimet nga komuna kur demolohen rrugët, hapen gropat, prishet struktura e asfaltit)	74
Tabela 19: Infrastruktura rrugore dhe mirëmbajtja – Kënaqshmëria e qytetarëve me sinjalistikën rrugore, shenjat për këmbësorë, shpejtësinë e kufizuar, paralajmërimin për afërsinë e shkollave, hapësirave publike	75
Tabela 20: Trotualet – Kënaqshmëria e qytetarëve me trotualet (gjatësinë e tyre, gjerësinë, mundësitë për lëvizje dhe mirëmbajtjen e tyre).....	76
Tabela 21: Ndriçimi publik – Kënaqshmëria e qytetarëve me ndriçimin publik në rrugë dhe hapësira publike (parqe, sheshe)	77
Tabela 22: Parkingjet publike – Kënaqshmëria e qytetarëve me ekzistencën e hapësirave publike për parkingje	78
Tabela 23: Parqet, sheshet dhe hapësirat publike – Kënaqshmëria e qytetarëve me numrin e parqeve dhe shesheve	79
Tabela 24: Parqet, sheshet dhe hapësirat publike – Kënaqshmëria e qytetarëve me mundësitë që ofrojnë sheshet për rekreacion, tubime, shëtitje, etj.....	80
Tabela 25: Parqet, sheshet dhe hapësirat publike – Kënaqshmëria e qytetarëve me hapësirat gjelbëruese në vende publike	81
Tabela 26: Parqet, sheshet dhe hapësirat publike – Kënaqshmëria e qytetarëve me mirëmbajtjen e parqeve, shesheve dhe hapësirave publike	82
Tabela 27: Transporti publik – Kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet e transportit publik	83
Tabela 28: Transporti publik – Kënaqshmëria e qytetarëve me oraret e qarkullimit të transportit publik	84

Tabela 29: Uji i pijshëm – Kënaqshmëria e qytetarëve me përfshirjen në sistemin e ujësjellësit.....	85
Tabela 30: Uji i pijshëm – Kënaqshmëria e qytetarëve me furnizimin me ujë.....	86
Tabela 31: Uji i pijshëm – Kënaqshmëria e qytetarëve me cilësinë e ujit.....	87
Tabela 32: Mbeturinat – Kënaqshmëria e qytetarëve me grumbullimin e mbeturinave, përfshirë respektimin e orarit të grumbullimit të tyre	88
Tabela 33: Kanalizimi – Kënaqshmëria e qytetarëve me trajtimin e ujërave të zeza/kanalizimit	89
Tabela 34: Planifikimi urban dhe rural – Kënaqshmëria e qytetarëve me planifikimin urban dhe rural.....	90
Tabela 35: Kënaqshmëria me pushtetin lokal – Kënaqshmëria e qytetarëve me punën e kryetarit të komunës	91
Tabela 36: Kënaqshmëria me pushtetin lokal – Kënaqshmëria e qytetarëve me punën e kuvendit komunal	92
Tabela 37: Kënaqshmëria me pushtetin lokal – Kënaqshmëria e qytetarëve me punën e drejtorive komunale.....	93
Tabela 38: Transparenca – Informimi i qytetarëve me punën e komunës.....	94
Tabela 39: Transparenca – Informimi i qytetarëve në 12 muajt e fundit për ndonjë takim publik, mbledhje të kuvendit komunal apo takim tjetër të organizuar nga komuna.....	95
Tabela 40: Vendimmarrja – Pjesëmarrja e qytetarëve në 12 muajt e fundit në ndonjë takim publik për shqyrtimin e një dokumenti strategjik, apo rregullore komunale.....	96
Tabela 41: Vendimmarrja – Pjesëmarrja e qytetarëve në ndonjë takim për planifikim të buxhetit komunal.....	97
Tabela 42: Vendimmarrja – Në rast të pjesëmarrjes së qytetarëve në takime publike për planifikimin e buxhetit komunal, marrja parasysh e kërkesave të tyre	98

Hyrje

Shërbimet publike komunale janë shërbime që ofrohen nga komuna për qytetarët që jetojnë brenda juridiksionit të saj, drejtpërdrejtë ose duke e financuar ofrimin e shërbimeve. Rrjedhimisht, komuna është institucioni primar publik i qeverisjes përmes të cilës qytetarët marrin shërbime dhe është më se i nevojshëm skanimi i kënaqshmërisë së qytetarëve së paku në baza vjetore.

Anketa “Indeksi i kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet komunale”, ka bërë vlerësimin e kënaqshmërisë së qytetarëve të Prishtinës, me shërbimet komunale. Të dhënat e dala nga anketa, përfaqësojnë mendimet e qytetarëve të moshës 18 vjeç e më shumë, gra dhe burra, të cilët janë intervistuar përgjatë muajve prill dhe maj 2018, në zonat urbane dhe rurale të Prishtinës.

Anketa është dizajnuar të bëjë vlerësimin e kënaqshmërisë me shërbimet komunale, të cilat ofrohen nga komuna bazuar në kompetencat vetanake. Anketa përshinë 15 lloje të ndryshme të shërbimeve komunale, si dhe matjen e kënaqshmërisë së qytetarëve me pushtetin lokal duke i pyetur qytetarët për nivelin e kënaqshmërisë së tyre me punën e Kryetarit të Komunës, Kuvendit Komunal, si dhe Drejtorive Komunale. Gjithashtu, anketa ka bërë edhe vlerësimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe stadi të informimit të qytetarëve me punën e autoriteteve komunale.

Ky raport do të ofrojë të dhëna specifike të kënaqshmërisë së përgjithshme të prishtinasve për këto lloje të shërbimeve: Shërbime administrative; Shëndetësi; Arsim; Sport; Kulturë dhe Rini; Infrastrukturë rrugore dhe mirëmbajtje; Trotuare; Ndriçim Publik; Parkingje Publike; Parqe Sheshe dhe Hapësira Publike; Transporti Publik; Uji i Pijshëm; Mbeturina; Kanalizim; Planifikim urban dhe rural.

INPO synon që këtë Indeks ta realizoj në vazhdimësi, në mënyrë që të kemi të dhëna reale të kënaqshmërisë me performancën e komunës, rezultatet e së cilit do të ndikonin në prioritizimin e investimeve dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve komunale. Në këtë raport nuk janë bërë krahasimet e rezultateve me ato të vitit të kaluar për arsye se në këtë vit INPO ka vendosur shkallën neutrale të vlerësimit në pyetësor. Rrjedhimisht, krahasimi i të dhënave nuk do të ishte efikas dhe real.

Përmbledhje ekzekutive

Ky është Indeksi i dytë i vlerësimit të kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet komunale në Prishtinë, i cili bazohet në anketën e zhvilluar gjatë muajve prill dhe maj 2018 dhe është vazhdimësi e Indeksit të vitit të kaluar, i publikuar në gusht 2017.

Të dhënat e dala nga anketa, përfaqësojnë mendimet e qytetarëve të moshës 18 vjeç e më shumë, gra 50.12% dhe 49.88% burra, të cilët janë intervistuar përgjatë muajve prill dhe maj 2018. Mostra sipas strukturës së vendbanimit ka përfshirë 79.48% të të anketuarve nga vendbanimet urbane dhe 20.12% nga ato rurale.

Të dhënat e Indeksit tregojnë se shërbimet komunale si, cilësia e arsimit, aktivitetet sportive, mbështetja e klubeve sportive, aktivitetet rinore, gjendja dhe mirëmbajtja e rrugëve, trotualet, parkingjet publike, hapësirat gjelbëruese, kanalizimi, planifikimi urban dhe rural dominojnë në listën e pakënaqësive të qytetarëve. Ndërkaq, më shumë se 40% e qytetarëve janë deklaruar të kënaqur sa i përket punës së kryetarit të komunës prej kur e ka filluar mandatin, mirëpo të pakënaqur janë deklaruar në raport me punën e drejtorive komunale. Ndërsa, vetëm një e katërta e prishtinasve janë të kënaqur me punën e kuvendit komunal.

Mesatarja aritmetike e kënaqshmërisë me të gjitha shërbimet komunale është 39.81% ndërsa e pakënaqshmërisë 31.13%. Mesatarja aritmetike e qytetarëve me qëndrim neutral, as të kënaqur e as të pakënaqur me shërbimet komunale është 21.38%.

Më shumë se gjysma e qytetarëve të Prishtinës janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimet e administratës komunale. Saktësia dhe shpejtësia e pajisjes më dokumente të gjendjes civile, lejeve ndërtimore, leje biznesi është vlerësuar e kënaqshme nga 66.83% e qytetarëve.

Pak më shumë se gjysma e prishtinasve janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimet shëndetësore që ofrohen nga QKMF-ja, QMF-të dhe ambulatat shëndetësore. Vetëm 19.53% e qytetarëve janë deklaruar të pakënaqur apo shumë të pakënaqur. Vlerësim neutral kanë dhënë 20.76% e qytetarëve.

Qytetarët janë të pakënaqur me cilësinë e arsimit parauniversitar. Një e treta e qytetarëve janë deklaruar se janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur. Po ashtu, pothuajse një e treta e qytetarëve të tjerë të anketuar janë shprehur të kënaqur apo shumë të kënaqur. Dallimi mes qytetarëve të kënaqur dhe atyre të pakënaqur me cilësinë e arsimit parauniversitar është 3.45%, Ndërsa 29.98% e qytetarëve kanë vlerësim neutral. Vlen të theksohet, se pakënaqshmëria me cilësinë e arsimit është më shumë e shprehur në zonat urbane se sa në zonat rurale. 41.15% e qytetarëve janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me infrastrukturën e ambienteve shkollore kundrejt 27.65% të cilët janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur. Gjithashtu, 26.90% e qytetarëve kanë vlerësim neutral.

Në përgjithësi qytetarët janë të kënaqur me përfshirjen në sistemin e ujësjellësit, furnizimit me ujë, cilësinë e ujit dhe grumbullimit të mbeturinave, shërbime këto që ofrohen nga ndërmarrjet publike lokale dhe rajonale. Mirëpo, më shumë se një e treta e qytetarëve apo 41.40% nuk janë të kënaqur me trajtimin e ujërave të zeza/kanalizimeve. Pakënaqshmëria është më e madhe në zonat urbane, ku 43.90% e qytetarëve janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me trajtimin e ujërave të zeza/kanalizimeve.

Aktivitetet kulturore, sportive dhe rinore janë vlerësuar negativisht nga qytetarët. 39.69% e qytetarëve janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me aktivitetet sportive që organizohen në Prishtinë. Ndërsa, 20.64% janë as të kënaqur as të pakënaqur. Pakënaqshmëria është më e madhe tek grupmoshat 40-49 vjeç, ku 44.53% e tyre deklarohen të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me organizimin e aktiviteteve sportive. Ndërkaq, 37.10% e qytetarëve janë deklaruar se nuk dinë për mbështetjen komunale që u ofrohet klubeve sportive, kundrejt 35.87% të atyre që dinë por janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me mbështetjen që ofron komuna për klubet e sportit. Më shumë se një e treta e qytetarëve po ashtu është e pakënaqur me aktivitetet rinore që organizohen nga komuna, vetëm 21.25% e qytetarëve janë të kënaqur me këto aktivitete. Të dhënat kanë treguar që dallimi i qytetarëve të kënaqur dhe të pakënaqur me aktivitetet kulturore është 1.36%. Të kënaqur apo shumë të kënaqur me aktivitetet kulturore të organizuara nën patronatin e komunës së Prishtinës janë 32.19%, ndërsa 30.83% janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur. 17.44% e qytetarëve kanë vlerësim neutral.

45.94% e qytetarëve janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me gjendjen e rrugëve, respektivisht me cilësinë e asfaltit dhe gjerësinë e rrugëve. Pakënaqësia shprehet pothuajse ekuivalente kur është fjala për mirëmbajtjen e tyre. 44.96% qytetarëve janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me intervenimet nga komuna kur demolohehen rrugët, hapen gropat apo prishet struktura e asfaltit. Pakënaqësia me këto shërbime është më e madhe në zonat urbane sesa në ato rurale. Mirëpo, qytetarët janë të kënaqur me sinjalistikën rrugore. 46.93% e qytetarëve janë shprehur të kënaqur apo shumë të kënaqur me shenjëzimet për këmbësorë, tabelat për shpejtësinë e kufizuar, paralajmërimet për afërsinë e shkollave/institucioneve etj.

Mbi gjysma e qytetarëve prishtinas vlerësojnë se është e kufizuar mundësia për të lëvizur lirshëm në trotuare. 64.01% kanë deklaruar se janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me gjatësinë dhe gjerësinë e trotuareve, mundësinë për lëvizje të lirë dhe mirëmbajtjen e tyre. 63.98% e të pakënaqurve i takojnë zonave urbane të komunës.

Në përgjithësi qytetarët mendojnë se është i mjaftueshëm ndriçimi publik në hapësira publike dhe rrugë. Më shumë se gjysma e qytetarëve janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me ndriçimin publik, kundrejt 19.53% e atyre që nuk janë të kënaqur. 21.25% kanë qëndrim neutral sa i përket këtij shërbimi.

Mungesa e parkingjeve publike është reflektuar me nivel të lartë të pakënaqshmërisë së qytetarëve të Prishtinës. 78.00% e tyre shprehen të pakënaqur apo shumë të pakënaqur me kapacitetin aktual të parkingjeve publike. Vetëm 5.65% janë të kënaqur. Nivel më të lartë të pakënaqshmërisë me parkingjet publike shprehin burrat. Të pakënaqur/a janë 82.77% burra dhe 73.29% gra.

45.94% e qytetarëve janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me numrin e shesheve dhe parqeve në Prishtinë, kundrejt 26.41% e atyre që janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur. Vlerësim neutral për këto kategori kanë shprehë 26.54% e qytetarëve. Vlerësim pozitiv kanë qytetarët sa i përket mundësive që ofrojnë parqet dhe sheshet për rekreacion, tubime dhe shëtitje. Të kënaqur apo shumë të kënaqur janë 51.72% e qytetarëve, ndërsa 18.55% e tyre janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur. 24.82% janë as të kënaqur as të pakënaqur. Mirëpo, të njëjtat vlerësime qytetarët nuk i kanë sa i përket hapësirave gjelbëruese në hapësira publike, parqe dhe sheshe. 42.99% e qytetarëve janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur. Vetëm 29.00% e qytetarëve shprehen të kënaqur apo shumë të kënaqur me gjelbërimin, ndërsa 26.54% kanë qëndrim neutral. Kënaqshmëria e qytetarëve më mirëmbajtjen e këtyre hapësirave kryesisht është e kënaqshme. 46.56% e qytetarëve shprehen të kënaqur apo shumë të kënaqur, 19.54% të pakënaqur apo shumë të pakënaqur dhe 30.47% e tyre janë as të kënaqur as të pakënaqur.

Shërbimet e transportit publik janë vlerësuar lartë nga qytetarët. 66.83% janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me këto shërbime. 15.36% e qytetarëve shprehen të pakënaqur apo shumë të pakënaqur, ndërsa 12.29% kanë vlerësim neutral. Kënaqshmëria e qytetarëve zbehet sa i përket kënaqshmërisë me oraret e qarkullimit të mjeteve të transportit publik. 58.11% janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me oraret e qarkullimit, të pakënaqur apo shumë të pakënaqur janë 21.63% dhe 13.27% të qytetarëve janë as të kënaqur as të pakënaqur.

Planifikimi urban dhe rural është vlerësuar negativisht nga qytetarët. 40.30% e qytetarëve janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur, 26.29 kanë vlerësim neutral, ndërsa vetëm 19.04% e qytetarëve janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me planifikimin urban dhe rural. Pakënaqshmëria me këtë shërbim është më e shprehur tek qytetarët që jetojnë në zonat urbane.

Qytetarët kanë vlerësime të ndryshme sa i përket performancës së organeve komunale. Të kënaqur apo shumë të kënaqur me punën e kryetarit të komunës prej kur e ka filluar mandatin janë 41.89% e qytetarëve, kundrejt 24.69% e atyre që janë të pakënaqur apo shumë të pakënaqur. 29.61% e qytetarëve kanë vlerësim neutral për punën e kryetarit. Pak më shumë se gjysma e qytetarëve të kënaqur apo shumë të kënaqur me punën e kryetarit jetojnë në zona rurale, respektivisht, 53.29%. Vlerësim negativ kanë dhënë qytetarët për punën e drejtorive komunale. 32.68% e tyre janë të pakënaqur apo shumë

të pakënaqur, ndërkaq vetëm 20.64% e qytetarëve janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me punën e drejtorive. Ndërsa, me punën e kuvendit komunal 29.86% e qytetarëve janë shprehur të pakënaqur apo shumë të pakënaqur. 22.11% e prishtinasve janë të kënaqur apo shumë të kënaqur me punën e kuvendit komunal dhe 26.66% janë shprehur as të kënaqur as të pakënaqur.

Kënaqshmërinë e qytetarëve me transparencën komunale dhe informimin rreth punëve të komunës të dhënat e pasqyrojnë në këtë nivel. 25.80% e qytetarëve ndjehen të informuar rreth punëve që kryen komuna, ndërkaq 47.91% ndjehen pak të informuar dhe 23.83% deklarohen të painformuar fare. Ndërsa, vetëm 29.85% e qytetarëve kanë pohuar se në vitin e fundit janë informuar nga komuna për organizimin e takimeve publike, mbledhjeve të kuvendit apo takimeve të natyrës tjetër, kurse 62.90% kanë mohuar të janë informuar. Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes vazhdon të jetë rregull i pazbatuar nga komuna e Prishtinës. Sipas anketës, 96.81% e qytetarëve gjatë 12 muajve të fundit, asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë takim publik për shqyrtim të ndonjë dokumenti strategjik a rregullore komunale. Vetëm 2.95% e tyre kanë deklaruar se kanë qenë pjesë e vendimmarrjes. Po ashtu, 98.28% e qytetarëve kanë deklaruar se gjatë 12 muajve të fundit nuk kanë marrë pjesë në asnjë takim publik për planifikimin e buxhetit komunal. Vetëm 1.47% e tyre kanë pohuar se kanë marrë pjesë. Gjysma e qytetarëve që kanë marrë pjesë në këto takime janë deklaruar se komuna nuk i merr parasysh propozimet apo kërkesat e tyre për përfshirje në buxhetin e vitit të ardhshëm. 41.67% e tyre pohojnë komuna i merr parasysh kërkesat e tyre.




Figura 1: Kënaqshmëria e përgjithshme me shërbimet publike komunale, pjesa e parë




Figura 2: Kënaqshmëria e përgjithshme me shërbimet publike komunale, pjesa e dytë




Figura 3: Kënaqshmëria e përgjithshme me shërbimet publike komunale, pjesa e tretë

Metodologjia e hulumtimit

Raporti pasqyron perceptimet e qytetarëve të Prishtinës rreth kënaqshmërisë me shërbimeve publike, të cilat i ofron komuna e Prishtinës në kuadër të kompetencave vetanake. Anketimi është realizuar sy me sy duke përdorur pyetësin me pyetje të mbyllura, respektivisht alternativat e përgjigjeve në pyetësor janë dizajnuar sipas modelit shumë shkallësh (Shkalla e Likertit). Pyetësi ka përmbajtur gjithsej 36 pyetje të ndara në 15 fusha/kompetenca vetanake, ndërsa fusha e fundit e matjes përfshinë kënaqshmërinë me organet e pushtetit lokal dhe nivelin e informimit të qytetarëve me punën e komunës. INPO për arsye objektive ka larguar nga matja nivelin e kënaqshmërisë së qytetarëve rreth të drejtave të njeriut, shërbimet sociale dhe familjare dhe menaxhimit të fatkeqësive, të cilat po ashtu janë kompetencë vetanake e komunës.

Në punën e terrenit janë angazhuar dhjetë (10) anketues të INPO-s. Intervistat janë realizuar gjatë muajve prill dhe maj duke u intervistuar 814 qytetarë. Mostra përfaqëson qytetarët 18 vjet më të vjetër, gra 50.12% dhe 49.88% burra. Mostra nuk përmban strukturën etnike të qytetarëve të intervistuar. Shpërndarja e mostrës në zona urbane (79.48%) dhe rurale (20.52%) është bazuar në të dhënat e regjistrimit të fundit të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës. Sipas kësaj mostre, 1 anketë përfaqëson 250 qytetarë.

Zgjedhja e mostrës së rëndomtë është bërë sipas teknikës së “ditëlindjes më të afërt”. Kjo mostër siguron që secili qytetarë i Prishtinës ka probabilitet të njëjtë për tu zgjedhur për intervistim. Regjistrimi dhe përpunimi i të dhënave të anketave është bërë me softuerin SPSS 23 dhe margjina e gabimit është +/- 1.50%.

Demografia e të anketuarve

42.14% e qytetarëve të anketuar në kuadër të Indeksit së kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet komunale të komunës së Prishtinës i kanë takuar grupmoshës 18-29 vjeç, grupmoshës 30-39 i kanë takuar 21.74% e qytetarëve të anketuar, grupmoshës 40-49 vjeç i kanë takuar 16.83% dhe 19.29% e qytetarëve të anketuar i kanë takuar grupmoshës mbi 50 vjeç.

Nga gjinia e qytetarëve të anketuar, 50.12% janë të gjinisë femërore ndërsa 49.88% të gjinisë mashkullore.

79.48% e qytetarëve të anketuar jetojnë në vendbanim urban, ndërsa 20.52% e tyre jetojnë në vendbanim rural.

54.67% e qytetarëve të anketuar kanë pas të përfunduar si gradën më të lartë arsimore shkollën e mesme të lartë, 31.70% nivelin bachelor të studimeve universitare ndërsa 8.72% shkollën fillore dhe të mesme të ulët. 4.91% e qytetarëve të anketuar kanë të përfunduar studime postdiplomike.

Sipas statusit të punës, 52.70% e të anketuarve janë të punësuar ndërsa 47.30% të papunësuar.

Gjinia dhe vendbanimi i qytetarëve të anketuar kanë qenë të përcaktuara nga regjistrimi i vitit 2011 të popullsisë së Republikës së Kosovës ku nga 198,897 banorë që rezultojnë të ketë Prishtina, 99,536 i kanë takuar gjinisë femërore ndërsa 99,361 gjinisë mashkullore.

164,296 banorë të komunës së Prishtinës sipas regjistrimit të fundit të popullsisë jetojnë në një njëri nga katër zonat urbane ndërsa 34,601 jetojnë në zonat rurale të komunës së Prishtinës.




Figura 4: Demografia e të anketuarve – Mosha e të anketuarve




Figura 5: Demografia e të anketuarve – Gjinia e të anketuarve




Figura 6: Demografia e të anketuarve – Vendbanimi i të anketuarve




Figura 7: Demografia e të anketuarve – Niveli i arsimit i të anketuarve




Figura 8: Demografia e të anketuarve – Statusi i punës i të anketuarve

Shërbimet administrative

74.45% e qytetarëve të anketuar kanë deklaruar që kanë vizituar komunën në 12 muajt e fundit për të kërkuar ndonjë shërbim sikurse lëshim të certifikatës së lindjes, certifikatë të martesës, certifikatë të vdekjes, leje biznesore/ndërtimi ose shërbim të ngjashëm, ndërsa 24.94% e të anketuarve deklarojnë që në 12 muajt e fundit nuk e kanë vizituar komunën fare për të kërkuar këto shërbime.

Administrata komunale është efikase në lëshimin e dokumenteve të përmendura më lartë pohojnë 81.57% e qytetarëve të anketuar, 7.62% deklarojnë që nuk është efikase, ndërsa 10.81% janë deklaruar që nuk e dinë.




Figura 9: Shërbimet administrative – Vizitimi i komunës nga qytetarët në 12 muajt e fundit për të kryer shërbime administrative; Efikasiteti i komunës/administratës publike në lëshimin e dokumenteve

Sa i përket saktësisë dhe shpejtësisë së administratës komunale në ofrimin e dokumentit/shërbimit, 47.54% e qytetarëve deklarohen që janë ndarë të kënaqur herën e fundit kur kanë qenë në komunë, 19.29% e qytetarëve janë ndarë shumë të kënaqur dhe 13.64% e qytetarëve as të kënaqur e as të pakënaqur. 6.51% e qytetarëve herën e fundit që kanë marrë shërbim në komunë janë ndarë të pakënaqur me saktësinë dhe shpejtësinë e marrjes së shërbimit, 1.84% shumë të pakënaqur dhe 10.57% e qytetarëve janë deklaruar me nuk e di. 0.61% e qytetarëve të anketuar kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje.




Figura 10: Shërbimet administrative - Kënaqshmëria e qytetarëve me saktësinë dhe shpejtësinë në marrjen e dokumentit/shërbimit të kërkuar herën e fundit kur e kanë vizituar komunën

Shëndetësia

38.08% dhe 16.83% e qytetarëve të anketuar në komunën e Prishtinës deklarohen si të kënaqur ose shumë të kënaqur respektivisht me shërbimet shëndetësore të ofruara nga QKMF-ja, QM-të dhe ambulatat shëndetësore, ndërsa 20.76% e tyre deklarohen as të kënaqur e as të pakënaqur. 14.62% e qytetarëve deklarohen si të pakënaqur me shërbimet shëndetësore të ofruara nga komuna e Prishtinës, dhe 4.91% e të anketuarve deklarohen shumë të pakënaqur. 4.67% e qytetarëve janë përgjigjur me nuk e di. 0.12% e qytetarëve janë refuzoj të përgjigjem.




Figura 11: Shëndetësia – Kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimet shëndetësore të ofruara nga QKMF-ja, QM-të dhe ambulatat shëndetësore

43.40% e të anketuarve që janë deklaruar të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me shërbimet shëndetësore të ofruara nga QKMF-ja, QM-të dhe ambulatat shëndetësore thonë që arsyeja kryesore e pakënaqshmërisë së tyre është cilësia e shërbimit të ofruar.

32.08% e të deklaruarve të pakënaqur ose shumë të pakënaqur e cilësojnë mungesën e barnave dhe produkteve medicinale si arsye kryesore të pakënaqshmërisë së tyre, 10.69% mungesën e mjekëve specialist ndërsa 5.66% deklarohen për qasjen e kufizuar/të vështirë në objektet shëndetësore. 8.18% e tyre thonë që kanë të tjera arsye të pakënaqshmërisë me shërbimet shëndetësore të ofruara nga komuna e Prishtinës.

Cilësia e shërbimit të ofruar si arsye e pakënaqshmërisë vërehet më shumë tek të anketuarit e moshës 40-49 vjeç ku 57.69% e të pakënaqurve me shërbimet shëndetësore si arsye kryesore e ofrojnë cilësinë e shërbimit të ofruar. Ndërsa, 40.63%

e të pakënaqurve të grupmoshës 30-39 vjeç thonë që mungesa e barnave dhe produkteve medicinale është arsye kryesore e pakënaqshmërisë.

Gjithashtu, dallim vërehet në bazë të vendbanimit të të anketuarve, ku 34.15% e të pakënaqurve me shërbimet shëndetësore të vendbanimit urban arsye kryesore e japin mungesën e barnave dhe produkteve medicinale kundrejt 25.00% të vendbanimit rural që e japin këtë arsyetim.

Duhet të përmendet që shumë nga qytetarët kanë renditur cilësinë e shërbimit të ofruar si arsye kryesore të pakënaqshmërisë me shërbimet shëndetësore duke konsideruar që kjo i përfshinë në vete edhe arsyet e tjera që kanë mundur t'i zgjedhin.

Arsyet e pakënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet shëndetësore




Figura 12: Shëndetësia – Arsyet e pakënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet shëndetësore të ofruara nga QKMF-ja, QM-të dhe ambulatat shëndetësore

Arsimi

Me cilësinë e arsimit parauniversitar që përfshin arsimin publik deri në përfundim të shkollës së mesme të lartë, klasës së 12-të, janë deklaruar si të kënaqur 29.73% e qytetarëve ndërsa 29.61% e tyre janë deklaruar si të pakënaqur. 29.98% e të anketuarve deklarohen as të kënaqur e as të pakënaqur me cilësinë e arsimit parauniversitar, 1.84% shumë të kënaqur dhe 5.41% janë deklaruar shumë të pakënaqur.

3.19% e qytetarëve janë deklaruar që nuk e dinë.

Përqindja më e madhe e pakënaqshmërisë me cilësinë e arsimit parauniversitar vërehet tek të anketuarit e moshës mbi 50 vjeç ku 33.76% dhe 10.19% e tyre janë deklaruar të pakënaqur dhe shumë të pakënaqur respektivisht. Gjithashtu, pakënaqshmëria me cilësinë e arsimit parauniversitar në komunën e Prishtinës shihet të jetë më e madhe në zonën urbane sesa në zonat rurale. 31.68% e të anketuarve të zonës urbane deklarohen si të pakënaqur kundrejt 21.56% të të anketuarve të zonës rurale që deklarohen kësisoj, ndërsa shumë të pakënaqur deklarohen 5.56% e të anketuarve të zonës urbane dhe 4.79% të zonës rurale të komunës së Ferizajt.




Figura 13: Arsimi – Kënaqshmëria e qytetarëve me cilësinë e arsimit parauniversitar

38.45% e qytetarëve të anketuar deklarohen si të kënaqur me infrastrukturën e ambienteve shkollore, ndërsa 24.82% të pakënaqur. 2.70% janë shumë të kënaqur kundrejt 2.83% të qytetarëve që deklarohen si shumë të pakënaqur me infrastrukturën e ambienteve shkollore.

20.27% deklarohen as të kënaqur e as të pakënaqur.




Figura 14: Arsimi – Kënaqshmëria e qytetarëve me infrastrukturën e ambienteve shkollore

Sporti

Në lidhje me kënaqshmërinë e qytetarëve me aktivitetet sportive që organizohen në komunën e Prishtinës, 28.26% e qytetarëve të anketuar janë deklaruar të pakënaqur dhe 11.43% shumë të pakënaqur, me një përqindje të përgjithshme prej 39.69% të pakënaqshmërisë. 17.08% e qytetarëve të anketuar deklarohen të kënaqur me aktivitetet sportive, 0.86% shumë të kënaqur dhe 20.64% as të kënaqur e as të pakënaqur.

21.74% e qytetarëve të anketuar nuk dinë për organizimin e aktiviteteve sportive në komunën e Prishtinës.

Pakënaqshmëria me organizimin e aktiviteteve sportive vërehet më së shumti tek të anketuarit e moshës 40-49 vjeç ku 32.12% dhe 12.41% e të anketuarve të kësaj grupmoshe deklarohen si të pakënaqur dhe shumë të pakënaqur respektivisht. 23.96% e kësaj grupmoshe deklarohen që nuk dinë për organizimin e aktiviteteve sportive.




Figura 15: Sporti – Kënaqshmëria e qytetarëve me organizimin e aktiviteteve sportive

37.10% e të anketuarve janë deklaruar që nuk dinë për mbështetjen komunale të klubeve sportive. 28.01% dhe 7.86% e qytetarëve të anketuar në komunën e Prishtinës deklarohen të pakënaqur dhe shumë të pakënaqur respektivisht me mbështetjen komunale për klubet sportive, 15.96% deklarohen as të kënaqur e as të pakënaqur, 9.95% të kënaqur dhe 0.37% shumë të kënaqur.

0.74% e qytetarëve të anketuar kanë refuzuar të përgjigjen në këtë pyetje.

Në zonat rurale të komunës së Prishtinës vërehet pakënaqshmëri më e madhe e qytetarëve me mbështetjen komunale të klubeve sportive ku 31.14% e të anketuarve në zonat rurale deklarohen të pakënaqur dhe 10.78% shumë të pakënaqur.




Figura 16: Sporti – Kënaqshmëria e qytetarëve me mbështetjen komunale të klubeve sportive

Kulturë dhe rini

